

**KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr. 467/10, datë 3.5.2013**

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës)”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për të gjitha pasuritë është bërë shënimi “Në proces rikonfirmimi dhe riverifikimi”, për arsye të konfirmimeve jo të plota lidhur me titujt e pronësisë dhe të dhënat e objekteve. Për të gjitha objektet do të kërkohej konfirmim pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, si dhe pranë ALUIZNI-t qendror dhe atij të Tiranës. Në bazë të të dhënave përfundimtare do të verifikohet vlerësimi i objekteve dhe do të hartohet lista përfundimtare, e cila do të propozohet për shpronësim pranë Këshillit të Ministrave.

Vlera totale e shpronësimit është 1 187 137 692 (një miliard e njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi**